



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kryetarja e Komunës**

**01nr** \_\_\_\_\_

**Dt: 28.05.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 10 dhe 33 i Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit nr. 06-31800-18/1 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve me dt: 07.05.2015, me të cilin është miratuar kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim e cila është e ndërlidhur me kërkesën e z. Smajl Cenaj nga fshati Planqor i Komunës së Gjakovës, për hapjen e pusit dhe sigurimin e ujit të pijes për familjen e tij, me dt. 28.05.2015 e miraton këtë:

**V E N D I M**

**1.** Miratohet kërkesa e z. Smajl Cenaj nga fshati Planqor i Komunës së Gjakovës nr. 16-352-31959 e dt. 07.05.2015 për mbulimin e shpenzimeve të hapjes së pusit dhe instalimit të pajisjeve për furnizim me ujë të pijes të familjes së tij, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në vlerë 1,100€.

**2.** Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,100€ nga mjetet e subvencioneve të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirlogarinë e z. Smajl Cenaj nr. 1930887483021128, BKT.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

**4.** Vendimi iu dërgohet :

- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Z. Smajl Cenaj, fshati Planqor, Komuna e Gjakovës.
- Arkivit

**Kryetarja e Komunës**

\_\_\_\_\_  
**Znj. Mimoza Kusari- Lila**